

Miratuar me Vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, ndryshuar me Vendimin nr. 177, datë 08.11.2016 dhe [Vendimin nr. 234, datë 20.12.2019](#)

Me të kuqe janë reflektuar shtesat dhe ndryshimet e propozura nga OSSH sh.a.

---

## **RREGULLORE PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES**

## PËRMBAJTJA

### **PJESA I: KËRKESA TË PËRGJITHSHME**

- 1.1 Qëllimi
- 1.2 Autoriteti
- 1.3 Përkufizime
- 1.4 Garantimi i lidhjes në Rrjetin e Shpërndarjes
- 1.5 Personat që kanë të drejtë të aplikojnë
- 1.6 Kërkesa për Lidhje të re
- 1.7 Kriteret për vlerësimin e Lidhjes së re apo modifikimin e lidhjes ekzistuese
- 1.8 Leja për hyrjen në objekt
- 1.9 Kërkesat teknike për një lidhje të re
- 1.10 Përgjegjësia e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes
- 1.11 Përgjegjësia e instalimeve të brendshme elektrike të objektit të aplikuesit.
- 1.12 Mënyra e komunikimit
- 1.13 Mënyra e aplikimit
- 1.14 Kërkesa për furnizim me energji elektrike nga dy burime të pavarura

### **PJESA II: DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR APLIKIMIN E NJË LIDHJE TË RE**

### **PJESA III: PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR NJË LIDHJE TË RE.**

- 3.1 Procedurat dhe Afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të ulët.
  - 3.1.1 Procedurat dhe Afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të ulët për fuqi të instaluar 0 - 20 kW.
  - 3.1.2 Procedurat dhe Afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese kur fuqia e instaluar është 21-50 kW në tension të ulët
  - 3.1.3 Procedurat dhe Afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese kur fuqia e instaluar është 50-100 kW në tension të ulët
  - 3.1.4 Procedurat dhe Afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të mesëm TM
- 3.2 Burimet e reja të gjenerimit të energjisë elektrike
- 3.3 Procedura për zhvendosjen e aseteve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes
- 3.4 Mënyra e lidhjes në rrjet të burimeve të energjisë
- 3.5 Dokumentacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese
- 3.6 Projektimi i kabinës së transformimit dhe mënyrës së lidhjes
- 3.7 Vlefshmëria e dokumentacionit të paraqitur

## **PJESA IV: TARIFAT PËR LIDHJET E REJA**

- 4.1 Parimet e tarifave
- 4.2 Punimet / shërbimet që do të paguhen nga aplikanti.
- 4.3 Mënyra e pagesës
- 4.4 Struktura e tarifave të lidhjes së re
- 4.5 Kushte të tjera për lidhje në rrjetin shpërndarjes
- 4.6 Tarifat për lidhje në tension të ulët
- 4.7 Tarifat për lidhje në tension të mesëm
- 4.8 Tarifat për lidhje në tension të mesëm 35 kV
- 4.9 Tarifat për shtesë fuqie, modifikim lidhje ose transferim
- 4.10 Tarifat për lidhje në N/Stacione.
- 4.11 Tarifa për rastet e lidhjes nga disa burime të energjisë elektrike
- 4.12 Tarifa për lidhjen e burimeve të gjenerimit të energjisë elektrike
- 4.13 Kontrolli i kërkesës maksimale për fuqi
- 4.14 Sistemi i matjes së energjisë elektrike
- 4.15 Mirëmbajtja

## **PJESA V: PRONËSIA MBI LIDHJEN E RE**

- 5.1 Kufijtë e pronësisë
- 5.2 Të drejtat e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme

## **PJESA VI: DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

ANEKS 1\_ Marrëveshja e lidhjes së re

ANEKS 2 \_ Tarifat për lidhjet e reja

ANKES 3\_ Tarifat për lidhjet e reja me sistemin e shpërndarjes e vetëprodhuesve të energjisë elektrike nga dielli me kapacitet total të instaluar deri në 500 kwp

## PJESA I: KËRKESA TË PËRGJITHSHME

### 1.1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH dhe Përdoruesve të Sistemit të Shpërndarjes, të cilët kërkojnë të realizojnë një lidhje të re ose të modifikojnë lidhjet e tyre ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, të përcaktojnë procedurat, afatet dhe tarifat për kryerjen e këtij shërbimi nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe të realizojë një unifikim të cilësisë së punimeve, standardeve dhe karakteristikave teknike të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

### 1.2 Autoriteti

Kjo rregullore hartohet bazuar në:

- a) Ligjin Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”
- b) “Kodin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”
- c) “Metodologjinë e Llogaritjes së Tarifës së Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”

### 1.3 Përkufizime

**Aplikanti** është pala e interesuar që ka aplikuar ose është në proces aplikimi për lidhje të re, modifikim apo rritje të kapacitetit të lidhjes ekzistuese, në rrjetin e OSSH.

**Aplikim për Lidhje** është kërkesa për lidhje nga **Aplikanti** për lidhje të re, modifikim të lidhjes ekzistuese, përfshirë dhe rritjen e kapacitetit të lidhjes së vjetër, në rrjetin e OSSH.

**Shtuar- Tarifa për Aplikim (pagesa)** është pagesa që kryhet nga aplikanti në kohën kur aplikohet për lidhje, e cila mbulon studimin e pranueshmërisë së lidhjes në rrjetin e Shpërndarjes dhe përgatitjen e dokumentacionit për hartimin e Marrëveshjes së Lidhjes.

**Tarifa për Aplikim (pagesa)** është pagesa që kryhet nga aplikanti në kohën kur aplikohet për lidhje, e cila mbulon studimin e pranueshmërisë së lidhjes në rrjetin e Shpërndarjes dhe përgatitjen e dokumentacionit për hartimin e Marrëveshjes së Lidhjes.

**Formati i Aplikimit për Lidhje** janë formate tip për çdo lloj lidhje sipas nivelit të tensionit.

**Kapaciteti i Lidhjes** nënkupton fuqinë e plotë elektrike në MVA të ofruar për lidhje të re ose për rritje kapaciteti të lidhjes ekzistuese.

**Data e Lidhjes** është data në të cilën **Asetet për Lidhje** janë apo konsiderohen të jenë plotësisht të lidhura në rrjetin e OSSH dhe që vetë OSSH është në gjendje të sigurojë kapacitetin për Lidhje.

**Oferta për Lidhje** është një ofertë për lidhje në rrjetin e OSSH e dhënë sipas afateve të përcaktuara në këtë Rregullore

**Pala Përgjegjëse për Lidhje** është pala që mund të jetë **Aplikanti** ose/dhe OSSH që merr përgjegjësinë për procesin e projektimit, tenderimit, ndërtimit, testimit dhe energjizimit të një lidhjeje.

**Asetet e Lidhjes** janë asetet që përfshijnë pasurinë e luajtshme ( pajisjet ) dhe pasurinë e paluajtshme (ndërtesat)

**Shtuar- Tarifa e verifikimit dhe kolaudimit** fillestar te matesit jane tarifa per azhornimin e rrjetit, shpenzim administrative dhe kolaudim fillestar i matesave te energjise elektrike".

**Tarifa për Mbikëqyrje dhe Tarifa për Kolaudim** janë tarifa për kontrollin dhe vlerësimin e projektit teknik, mbikëqyrjen e ndërtimit, testimin dhe kolaudimit të lidhjes, të cilat paguhen nga **Aplikanti**

**Përdoruesi i Sistemit ose Përdoruesi** është i lidhuri në Sistemin e Shpërndarjes duke qenë konsumator i lidhur direkt, Gjenerues.

**Lidhja e Re** është linjë furnizimi TM, TU, kabinë transformacioni, pajisje të lidhura në rrjetin e Shpërndarjes në pikën/nyjen lidhëse, e përcaktuar me kVA ose MVA, në nivelin nominal të tensionit.

**Pika e lidhjes** është pika e lidhjes fizike të një Përdoruesi me rrjetin e Shpërndarjes.

**Pika e dorëzimit** është ambienti i instalimit të pajisjeve komutuese të magjistralit TM.

**Pika e matjes** është vendi fizik ku është realizuar pika e lidhjes dhe ku sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes. Pika fizike e matjes përcaktohet plotësisht nga marrëveshjet midis Palëve.

**Ambienti i matjes** është vendi fizik në të cilin realizohet matja e energjisë elektrike.

**Ambienti i klientit** është vendi fizik ku vendoset tërësia e pajisjeve elektrike të transformimit, që i shërben klientit për furnizimin me energji elektrike të objektit të tij.

**Lidhje e Perkoheshme** eshte lidhje e energjise elektrike e cila hapet vetem per subjekte sezonale per periudha te caktuara sipas kerkeses se aplikantit.

#### 1.4 Garantimi i lidhjes në Rrjetin e Shpërndarjes

OSSH do të sigurojë lidhjen në rrjetin e shpërndarjes të gjithë palëve të interesuara në përputhje me ligjin Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe me kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore.

#### 1.5 Personat që kanë të drejtë të aplikojnë

Aplikimi për Lidhje të re në Sistemin e Shpërndarjes mund të kryhet nga:

- a) Çdo person fizik apo juridik, i cili aplikon për realizimin e një Lidhje të re në Sistemin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (Aplikanti), në përputhje me detyrimet e përcaktuara në akt-marrëveshjen ndërmjet përdoruesit dhe OSSH.
- b) Përdoruesit ekzistues të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, të cilët kërkojnë të realizojnë një lidhje të re ose të modifikojnë lidhjet e tyre ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes. (Përdoruesi)
- c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të miratojë kërkesën për Lidhje të re, nëse Përdoruesi apo Aplikanti nuk ka plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe standardet si detyrim për zbatimin e kodeve dhe rregullave në fuqi ose kur rezulton debitor dhe nuk ka shlyer detyrimet e mëparshme ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.... .. ndaj Operatori i Sistemit te Shpërndarjes dhe Furnizuesit. Ne rast se ne nje objekt ka nje kontrate ekzistuese nuk mund te aplikohet lidhje e re

por vetem per modifikim te lidhjes ekzistuese (ne rasttt kur kemi vetem nje dokument pronesia).

## 1.6 Kërkesa për Lidhje të re

Kërkesa për Lidhje të re paraqitet pranë zyrave të OSSH për:

- a) Lidhje të objekteve (banimi apo biznesi) me rrjetin elektrik të Sistemit të Shpërndarjes;
- b) Rritjen e fuqisë së lidhjes ekzistuese;
- c) Kërkesë për lidhje të përkohshme;
- d) Lidhje në Sistemin e Shpërndarjes të burimeve gjeneruese.
- dh) Veteproduesit

## 1.7 Kriteret për vlerësimin e Lidhjes së re apo modifikimin e lidhjes ekzistuese

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për vlerësimin e një aplikimi për Lidhje të re apo modifikim të një lidhjeje ekzistuese do të respektojë kërkesat e:

1. Ligjit për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe të instalimeve elektrike;
2. Rregullat teknike të përcaktuara në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave;
3. Kushtet dhe rregullat e përcaktuara në Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes si dhe kriteret si vijon:
  - a) vendndodhjen e objektit për të cilin kërkohet lidhja, të plotësohet me koordinatat e konturit të sipërfaqes së tij;
  - b) distancën e objektit me pikën e lidhjes;
  - c) rrjetin shpërndarës të OSSH;
  - d) sigurinë e furnizimit me energji elektrike;
  - e) nivelet e rrymave të lidhjes së shkurtër, parametrat teknik, seksioni standard, IP, rryma e lidhjes së shkurtër, koha e veprimit të mbrojtjes;
  - f) të gjitha aplikimet e tjera për lidhje në të njëjtën pikë të Rrjetit të Shpërndarjes të OSSH.

Lidhjet e reja apo modifikimet e lidhjes ekzistuese nuk duhet të shkaktojnë efekte negative mbi klientët apo përdoruesit ekzistues dhe as nuk duhet të ndikohen nga efektet negative të klientëve apo përdoruesve ekzistues. Njëkohësisht ajo nuk duhet të shkaktojë efekte negative në rrjetin shpërndarës të OSSH, por do të respektojë standardin ISO 18001.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përcaktojë kushtet dhe mënyrën e realizimit të lidhjes së re si dhe parametrat teknik të pajisjeve që do të shërbejnë për lidhjen e klientëve të rinj me Sistemin e Shpërndarjes konform:

- standardeve të harmonizuara shqiptare (neni 34 i ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”);
- standardeve evropiane;
- standardeve të vetë shoqërisë OSSH;
- rregullave teknike dhe ligjin për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe të

instalimeve elektrike.

### **1.8 Leja për hyrjen në objekt**

Përdoruesit apo Aplikantët që paraqesin kërkesën për Lidhje të re kanë detyrimin që t'i sigurojnë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) të drejtën për të hyrë në objektet e tyre, duke i krijuar lehtësira të nevojshme, në mënyrë që ky i fundit të arrijë të vlerësojë të gjitha kërkesat dhe kushtet për lidhjen e re.

### **1.9 Kërkesat teknike për një lidhje të re**

Të gjitha punimet për realizimin e lidhjes së re në rrjetin shpërndarës të OSSH do të bëhen nga Aplikanti, mbi bazë të akt-marrëveshjeve dypalëshe me Operatorin e Shpërndarjes. Aplikanti duhet të respektojë:

- a) të gjitha standardet e cilësisë së materialeve sipas normave evropiane të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes
- b) karakteristikat teknike sipas normave të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes
- c) seksionet e kablove dhe rrymat e LSH të pajisjeve komutuese, të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes
- d) nivelin e humbjeve për pajisjet transformuese të furnizimit me energji elektrike të objektit të tij, në mënyrë që ti përgjigjen zhvillimeve të rrjetit shpërndarës edhe në të ardhmen, si dhe arkitekturën e komunikimit të pajisjeve digjitale me sistemin e Operatorit të Shpërndarjes, të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes
- e) kontrollin e pajisjeve nga laboratorë të tretë, të akredituar sipas standardeve të EU
- f) të gjitha normat e sigurimit teknik në përputhje me standardin ISO 18001 dhe të ligjeve, akteve nënligjore dhe rregullave në fuqi.

Të gjitha punimet me karakter ndërtimor, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe pajisjet kryesore të kabinave elektrike (çelat hyrëse/dalëse, çelat e transformatorëve, transformatorët e fuqisë, panelet e shpërndarjes së tensionit të ulët, panelet e matjes TM/TU, kabllot lidhëse me rrjetin e tensionit të mesëm dhe të ulet, etj) do të:

- a) kryhen nga Aplikanti sipas direktivave të dhëna në studimin e pikës së Lidhjes nga OSSH. Projektet duhet të realizohen nga inxhinierë të licencuar duke respektuar kriteret në Aneksin 1
- b) zgjidhen në bazë të standardeve dhe kërkesave të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes dhe në përputhshmëri me një akt-marrëveshje dypalëshe, të mundësohet kontrolli i tyre nga laboratorë të tretë, të akredituar nga EU.
- c) instalohen në përputhje me kërkesat dhe kushtet teknike të OSSH
- d) testohen nga Aplikanti në përputhje me të gjitha protokollet dhe detyrimet ligjore në fuqi dhe do të jenë konform standardeve teknike të cilat janë pjesë e Marrëveshjes së Lidhjes së re.
- e) mbikëqyren dhe kolaudohen nga OSSH.

### **1.10 Përgjegjësia e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për:

- a) Përgatitjen e kushteve teknike të lidhjes së re dhe specifikimet teknike të të gjitha pajisjeve që mund të përfshihen në realizimin e lidhjes së re.

- b) Përgatitjen e kostove respektive për çdo mundësi të realizimit të lidhjes së re, nëse aplikanti e dëshiron si operator ekonomik, për realizimin e instalimit të lidhjes së re të realizuar nga ai.
- c) Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, OSSH në çdo rast, përcakton kriteret dhe kushtet teknike që duhet të plotësohen për lidhjen me rrjetin, pavarësisht përzgjedhjes nga ana e aplikantit të operatorit të licencuar nga organet kompetente, që do të realizojë punimet e lidhjes.

### **1.11 Përgjegjësia e instalimeve të brendshme elektrike të objektit të aplikuesit.**

- a) Përdoruesi apo Aplikanti, i cili do të furnizohet me energji elektrike nëpërmjet lidhjes së re që kërkohet të realizohet, është përgjegjës për instalimin:
  - e të gjitha pajisjeve mbrojtëse nga lidhja e shkurtër
  - e pajisjeve të mbrojtjes nga lidhja me tokën
  - e pajisjeve të mbrojtjes nga mbitensionet (atmosferike, ato të komutimit dhe ato të mbrojtjes nga këputja e përcjellësit të neutralit) .
- b) Përdoruesi apo Aplikanti do të realizojë sistemin e tokëzimit të objektit dhe klientëve të tjerë, të cilët furnizohen me energji elektrike nga kjo lidhje e re, në përputhje me kushtet teknike dhe normat në fuqi **me ane te vetdeklarimit, apo dokumentacion tjetër.**
- c) Përdoruesi apo Aplikanti do të garantojë se të gjitha instalimet elektrike në të gjithë objektin që kërkohet të furnizohet me energji elektrike janë kryer, inspektuar dhe provuar nga një subjekt i pajisur me licencë për projektimin dhe instalimin e pajisjeve elektrike në përputhje me rregullat dhe kushtet teknike në fuqi **me ane te vetdeklarimit, apo dokumentacion tjetër.**
- d) Për asnjë aplikant apo përdorues nuk do dalë urdhri i dhënies së tensionit, nëse instalimet e brendshme nuk do të kenë mbrojtjet e përcaktuara në këtë paragraf.
- e) Përdoruesi apo Aplikanti do të marrë përsipër të çliroj nga çdo lloj përgjegjësie Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, për çdo lloj detyrimi që lidhet me dëmtime të çdo lloji të rrjetit shpërndarës, të shkaktuara prej instalimeve të brendshme të pajisjeve elektrike në objektin që kërkohet të lidhet me energji elektrike **me ane te vetdeklarimit, apo dokumentacion tjetër.**

### **1.12 Mënyra e komunikimit**

Si formë komunikimi do të jetë ajo me shkresë zyrtare e shoqëruar me numrin respektiv të protokollit. Gjatë hapave të ndryshëm të zbatimit të procedurave mund të pranohet edhe komunikimi me e-mail midis palëve për efekt të shkëmbimit vetëm të njoftimeve për përfundimin e disa hapave konkrete, sikurse janë të përcaktuara në këtë Rregullore.

**Aplikimi mund të bëhet edhe Online nëpërmjet aplikacionit në faqen zyrtare të shoqërisë" do të shtojmë edhe nëpërmjet aplikimit Online.**

### **1.13 Mënyra e Aplikimit**



Aplikimi për lidhjen e re do të bëhet sipas Formularit Tip të Aplikimit dhe do të kryhet:

1. Për fuqi të instaluar nga 0-20 kW - pranë zyrave të Kujdesit të Klientit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e banimit të aplikantit.
2. Për fuqi të instaluar nga 21 deri në 50 kW:
  - Për lidhjet në TU - pranë zyrave të Kujdesit të Klientit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e banimit të aplikantit.
  - Për lidhjet në TM - pranë zyrës së Kujdesit të Klientit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e vendndodhjes së objektit.
3. Për fuqi të instaluar më shumë se 50 kW - pranë zyrave të Kujdesit të Klientit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e vendndodhjes së objektit.

Detajet e vendndodhjes së zyrave të Kujdesit ndaj Klientit, informacion mbi Formularin Tip që do të përdoret për të aplikuar për Lidhje të re si edhe dokumentacionin e plotë që lidhet me kërkesat dhe kushtet teknike që duhet të respektohen për të projektuar dhe realizuar Lidhjen e re në çdo rreth, mund të gjenden në adresën përkatëse të internetit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

#### **1.14 Kërkesa për furnizim me energji elektrike nga dy burime të pavarura**

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të vlerësojë kërkesën për Lidhje të re me energji elektrike të objektit nga dy burime të pavarura të energjisë elektrike, në përputhje me Rregullat e Shfrytëzimit dhe Operimit të Sistemit të Shpërndarjes në zbatim të Kodit të Shpërndarjes.
2. Tarifat respektive për këto raste paraqiten në Pjesën IV të kësaj Rregulloreje.

## **PJESA II: DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR APLIKIMIN E NJË LIDHJE TË RE.**

### **Për Lidhje të Reja në TU**

#### **2.1 Fuqia e instaluar 0-20 kW**

Aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë për furnizimin me energji elektrike
2. Vërtetimi i identitetit (Fotokopje karte identiteti ose pasaporte)
3. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë si : Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi)
- ~~4. Fotokopje e Certifikatës së regjistrimit (për subjektet jofamiljare)~~
- ~~5. Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuar koordinatat e konturit të sipërfaqes së objektit).~~
- ~~6.4. Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë. Vetedeklarim nga aplikanti".~~

## 2.2 Fuqia e instaluar 20-50 kW

Aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë për furnizimin me energji elektrike
2. Vërtetimi i identitetit (Fotokopje karte identiteti ose pasaporte)
3. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronësisë si: Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi)
- ~~4. Fotokopje e Certifikatës së regjistrimit (për subjektet jofamiljare)~~
- ~~5.4.~~ Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi
- ~~6.5.~~ Planvendosja e të gjitha pajisjeve në objekt
- ~~7.6.~~ Licenca e inxhinierit elektrik, i cili ka bërë projektin elektrik të objektit.
- ~~8.7.~~ Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuara koordinatat e gjurmës së objektit).
- ~~9.8.~~ Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.
- ~~10.9.~~ Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlllogaritjen e të dhënave, i kryer nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.

## 2.3 Fuqia e instaluar 50 - 100 kW

Aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë për furnizimin me energji elektrike
2. Vërtetimi i identitetit (Fotokopje karte identiteti ose pasaporte)
3. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronësisë si : Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi)
- ~~4. Fotokopje e Certifikatës së regjistrimit (për subjektet jofamiljare)~~
- ~~5.4.~~ Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi
- ~~6.5.~~ Planvendosja e të gjitha pajisjeve në objekt
- ~~7.6.~~ Licenca e inxhinierit elektrik, i cili ka bërë projektin elektrik të objektit
- ~~8.7.~~ Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuara koordinatat e gjurmës së objektit).
- ~~9.8.~~ Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.
- ~~10.9.~~ Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlllogaritjen e të dhënave, i kryer nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.
- ~~11.10.~~ Leja e ndërtimit të objektit
- ~~12.11.~~ Grafiku i ngarkesës elektrike
- ~~13.12.~~ Relacion analitik për vlerësimin e  $\cos\phi$

## 2.4 Për Lidhje të Reja në TM

Aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë për furnizimin me energji elektrike
2. Vërtetimi i identitetit (Fotokopje kartë identiteti ose pasaporte)
3. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë si: Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme.
4. Fotokopje e Certifikatës së regjistrimit (për subjektet jofamiljare)
5. Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi..... **edhe projekti elektrik i kabines dhe linjes**
6. Planvendosja e të gjitha pajisjeve në objekt
7. Licenca e inxhinierit elektrik, i cili ka bërë projektin elektrik të objektit
8. Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuara koordinatat e gjurmës së objektit).
9. Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.
10. Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlogaritjen e të dhënave, i kryer nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.
11. Leja e ndërtimit të objektit
12. Grafiku i ngarkesës elektrike
13. Relacion analitik për vlerësimin e  $\cos\phi$

## PJESA III: PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR NJË LIDHJE TË RE.

### 3.1 Procedurat dhe Afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të ulët

#### 3.1.1 Procedurat dhe Afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të ulët për fuqi të instaluar 0 - 20 kW.

- a) Aplikanti bën kërkesën dhe paraqet dokumentacionin pranë zyrave të Kujdesit Ndaj Klientit të OSSH

- Afati i realizimit të Lidhjes së re për këto raste do të jetë:

~~i.—jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar deri në 10 kw~~

~~jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 10-20 kw~~ jo me shume se 20 dite pune.

~~ii.—~~

- b) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe do të kryejë miratimin e pikës dhe mënyrës së lidhjes në rrjet.
- c) Llogarit kostot për lidhjen e re.... **Pagesa e preventivit duhet te shlyhet nga aplikanti brenda 7 diteve pune nga manja e njoftimit. Ne rast te kundert aplikimi refuzohet, dhe duhet te riaplikohet.**

- d) Pas kryerjes nga aplikanti të pagesës së tarifës së lidhjes së re, OSSH zbaton të gjitha procedurat deri në furnizimin me energji elektrike të objektit.
- e) Lidhja me tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet në të njëjtën kohë me vendosjen e aparatit matës.
- f) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes rregjistron lidhjen e re ose modifikimin e kryer për aplikantin/klientin apo përdoruesin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij, brenda 3 ditëve pune pas vënies në tension. Operatori i Sistemit vë në dispozicion të Aplikantit informacionin e nevojshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer.
- g) Verifikimi i matësit të energjisë elektrike realizohet nga subjekti i pavarur, i autorizuar për verifikimin e matësive të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Test raporti i verifikimit të matësit elektrik dorëzohet nga subjekti i pavarur tek klienti dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.
- h) I gjithë informacioni i lidhjes së re ruhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në mënyrë elektronike dhe dokumentare.

### **3.1.2 Procedurat dhe Afatet kohore për Lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese kur fuqia e instaluar është 21-50 kW në TU**

- a) Për rastet kur fuqia e instaluar për një Lidhje të re ose për modifikimin e një lidhjeje ekzistuese, është 21-50 kW, në tension të ulët, procedurat dhe afatet kohore do të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në Pikën 3.1.1 (pika a-d).
- b) Lidhja nën tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet nga OSSH me anë të zbatimit të urdhrit të dhënies tension.
- c) Në rast se gjatë vënies në tension të objektit, lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen, atëherë Aplikanti është i detyruar, me shpenzimet e tij, të riparojë pjesën e dëmtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht si dhe të paguajë dëmin e shkaktuar.
- d) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron Përdoruesin apo Aplikantin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij/tyre brenda 2 ditëve pune pas vënies nën tension. Operatori i Sistemit vë në dispozicion të aplikantit, informacionin e nevojshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer dhe furnizuesi çdo muaj duhet të kryejë rakordimin me Operatorin e Shpërndarjes.
- e) Verifikimi i matësit të energjisë elektrike realizohet nga subjekti i pavarur, i autorizuar për verifikimin e matësive të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Test raporti i verifikimit të matësit elektrik dorëzohet nga subjekti i pavarur tek klienti dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.
- f) I gjithë informacioni i lidhjes së re ruhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në mënyrë elektronike dhe dokumentare.

### **3.1.3 Procedurat dhe Afatet kohore për Lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese kur fuqia e instaluar është 50-100 kW në TU.**

- a) Përdoruesi apo Aplikanti duhet të paraqesë projektin elektrik të objektit që kërkohet të furnizohet me energji elektrike. Ky projekt do të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, të ketë/të pasqyrojë të gjitha detajet konstruktive dhe mënyrën e realizimit të

instalimeve të brendshme të tij duke u shoqëruar me relacionin teknik përkatës për të treguar të gjitha ngarkesat elektrike dhe mënyrën e vendosjes së tyre brenda objektit. Projekti do të respektojë kushtet teknike të lidhjes së re që janë pjesë e kësaj rregullore. Ky projekt do të jetë i realizuar dhe përllëguar nga një inxhinier i licencuar ose kompani e licencuar për projektme elektrike.

- b) Periudha e vlerësimit prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të kërkesës së bërë nga Përdoruesi apo Aplikanti dhe paraqitja për pranim dhe nënshkrimi i Propozimit për lidhjen e “Marrëveshjes së Lidhjes së Re” nuk do të jetë më shumë se 20 ditë pune prej ditës së paraqitjes së aplikimit.
- c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë paraprakisht verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga Përdoruesi apo Aplikanti dhe nëse aplikimi nuk është i plotë, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë Përdoruesin apo Aplikantin me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data kur aplikimi është dorëzuar për vlerësim.
- d) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe në varësi të gjendjes së rrjetit elektrik në atë zonë, do të përgatisë mënyrën e lidhjes së objektit në rrjet. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë Propozimin dhe Marrëveshjen për Lidhjen e re dhe do t’ia dërgojë aplikantit për pranim sipas afateve të pikës 3.1.3/b.
- e) Propozimi për lidhjen e re, i përgatitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të pranohet nga aplikanti jo më vonë se pesë (5) ditë pune nga data që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes e ka vendosur propozimin e tij në dispozicion të aplikantit.
- f) Nëse aplikanti e pranon propozimin atëherë aplikanti do të paguajë detyrimet përkatëse brenda 5 ditëve pune nga njoftimi i propozimit të bërë, përndryshe propozimi bëhet i pavlefshëm dhe ai duhet të aplikojë përsëri për lidhje të re.
- g) Llogarit kostot për lidhjen e re.
- h) Pas kryerjes nga aplikanti të pagesës së tarifës së lidhjes së re, shlyerjes së detyrimeve të tjera dhe inspektimit brenda 3 ditëve pune nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, përgatitet urdhri për zbatimin e lidhjes së re. Sistemi i matjes së energjisë duhet të instalohet brenda 5 ditëve pune nga dita e nxjerrjes së raportit të instalimit të matjes për lidhjen në TU dhe 10 ditëve pune për lidhjen në TM. Lidhja nën tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet nga OSSH me anë të zbatimit të urdhrin të dhënies tension.
- i) Verifikimi i matësit të energjisë elektrike realizohet nga subjekti i pavarur, i autorizuar për verifikimin e matësive të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Test raporti i verifikimit të matësit elektrik i dorëzohet nga subjekti i pavarur tek klienti dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.
- j) Pajisjet e lidhjes së re sigurohen, instalohen dhe testohen nga vetë Aplikanti .
- k) Në rast se gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen, të instaluara nga Aplikanti, atëherë Aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht.
- l) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron aplikantin/përdoruesin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij brenda 2 ditëve pune pas vënies nën tension.

Nëse në Propozimin dhe Marrëveshjen e Lidhjes së Re është parashikuar lidhja e energjisë në

tensionin e mesëm dhe aplikanti pranon propozimin atëherë:

- a) Aplikanti dorëzon te Operatori i Sistemit të Shpërndarjes formularin e pranimit të Propozimit dhe Marrëveshjen e lidhjes së re të nënshkruar.
- b) OSSH zbaton të gjithë procedurat e parashikuara në këtë rregullore.
- c) Brenda 2 ditëve pune nga kryerja e pagesës, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë urdhrin administrativ për fillimin e projektit në përputhje me kërkesat dhe kushtet teknike të paraqitura në Marrëveshjen e lidhjes.
- d) Pas dorëzimit të projektit të detajuar të objektit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të analizoje atë dhe nëse projekti është në përputhje me kushtet teknike, brenda 2 ditëve pune Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të miratojë projektin dhe njoftojë aplikantin për të kryer të plotë pagesën e tarifës për lidhjen e re. Nëse aplikanti nuk kryen pagesën e tarifës brenda 5 ditëve pune prej momentit të miratimit dhe njoftimit të tij prej Operatorit të Shpërndarjes të mënyrës së lidhjes së tij në tensionin e mesëm të rrjetit shpërndarës, atëherë aplikimi dhe marrëveshja e lidhjes së re do të konsiderohen të pavlefshme dhe ai duhet të aplikojë përsëri për lidhje të re.
- e) Pas pagesës së tarifës së lidhjes së re nga ana e aplikantit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes zbaton të gjitha procedurat për fillimin e punimeve nga Aplikanti.
- f) Me fillimin e punimeve Aplikanti duhet të njoftojë OSSH, në mënyrë që ky i fundit të marrë masa për fillimin e procesit të Mbikëqyrjes, i cili kryhet nga OSSH.
- g) Në rastet kur kabina elektrike si pasuri e paluajtshme është ndërtuar nga aplikanti brenda objektit ose godinës e/i cili/a do të furnizohet me energji, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, do të japë aprovimin që ambienti i përshtatur për kabinë, është brenda kushteve teknike dhe e aksesueshme nga ta.
- h) Pas përfundimit të punimeve, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes merr masa për kryerjen e kolaudimit përfundimtar dhe nëse punimet janë kryer në përputhje me kushtet teknike, atëherë brenda 2 ditëve pune Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë pranimin dhe lejojë vendosjen e instalimit të sistemit të matjes sipas urdhrit të punës. Nëse gjatë kontrollit konstatohen të meta teknike, atëherë Aplikanti është i detyruar të përfundojë apo korrigjojë të metat e konstatuara.
- i) Pas përfundimit të instalimeve dhe pas marrjes në dorëzim të kabinës elektrike, brenda 1 dite pune Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit raportin e vendosjes së sistemit të matjes (matësa, bokse kolektive, etj) së energjisë elektrike, i cili duhet të instalohet brenda 5 ditëve pune nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes.
- j) Verifikimi i matësit të energjisë elektrike realizohet nga subjekti i pavarur, i autorizuar për verifikimin e matësive të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të bëra në ligjin Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Test raporti i verifikimit të matësit elektrik, dorëzohet nga subjekti i pavarur tek klienti dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.
- k) Pas vendosjes së sistemit të matjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit urdhrin e vënies nën tension të pajisjeve. Prova dhe vënia nën tension e pajisjeve do të kryhet brenda 3 ditëve pune dhe do të kryhet nga strukturat përgjegjëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

- l) Në rast se gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen, atëherë Aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jo funksionale, deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht.
- m) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron aplikantin/klientin apo përdoruesin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij/tyre brenda 5 ditëve pune pas vënies nën tension. Operatori i Sistemit vë në dispozicion të aplikantit/klientit informacionin e nevojshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer.
- n) Afatet e realizimit të lidhjes së re do të jenë 60 ditë pune të ndara sipas hapave:
  - Jo më shumë se 25 ditë pune për procedurën e aplikimit tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, kontrollin e aplikimit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, identifikimin e pikës së lidhjes, përgatitjen e dizajnit dhe llogaritjen e shpenzimeve.
  - Jo më shumë se 30 ditë pune për marrjen e lejeve përkatëse dhe realizimin e të gjitha punimeve ndërtimore, që do të kryhen nga Aplikanti.
  - Jo më shumë se 5 ditë pune për instalimin e sistemit të matjes.

### **3.1.4 Procedurat dhe Afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të mesëm TM**

- a) Përdoruesi apo Aplikanti duhet të paraqesë projektin elektrik të objektit që kërkohet të furnizohet me energji elektrike. Ky projekt duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, të ketë/të pasqyrojë të gjitha detajet konstruktive dhe mënyrën e realizimit të instalimeve të brendshme të tij duke u shoqëruar me relacionin teknik përkatës për të treguar të gjitha ngarkesat elektrike dhe mënyrën e vendosjes së tyre brenda objektit.  
  
Projekti duhet të respektojë kushtet teknike të lidhjes së re, të cilat janë pjesë e kësaj rregullore. Ky projekt duhet të jetë i realizuar dhe përllogaritur nga një inxhinier i licencuar ose kompani e licencuar për projektme elektrike.
- b) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë paraprakisht verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga Përdoruesi apo Aplikanti dhe nëse aplikimi nuk është i plotë, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë Përdoruesin apo Aplikantin me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data kur aplikimi është dorëzuar për vlerësim.
- c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe në varësi të gjendjes së rrjetit elektrik në atë zonë, do të hartojë studimin e fizibilitetit, do të përgatisë Propozimin dhe Marrëveshjen për Lidhjen e re dhe do t'ia dërgojë aplikantit për pranim sipas afateve.
- d) Propozimi për lidhjen e re, i përgatitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të pranohet nga aplikanti jo më vonë se pesë (5) ditë pune nga data që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes e ka vendosur propozimin e tij në dispozicion të aplikantit.
- e) Nëse aplikanti e pranon propozimin, atëherë dorëzon formularin e pranimin të ofertës, nënshkruan akt-marrëveshjen dhe paguan detyrimet përkatëse brenda 5 ditëve pune nga njoftimi i propozimit të bërë, përndryshe propozimi bëhet i pavlefshëm dhe ai duhet të aplikojë përsëri për lidhje të re.
- f) Pas pagesës së tarifës së lidhjes së re nga ana e aplikantit, Operatori i Sistemit të

Shpërndarjes zbaton të gjitha procedurat për fillimin e punimeve. Punimet do të kryhen nga operatori i licencuar nga organet kompetente, i zgjedhur nga Aplikanti për realizimin e lidhjes së re.

- g) Me fillimin e punimeve, aplikanti duhet të njoftojë OSSH, në mënyrë që ky i fundit të marrë masa për fillimin e procesit të mbikqyrjes, i cili kryhet nga OSSH.
- h) Në rastet kur kabina elektrike si pasuri e paluajtshme është ndërtuar nga aplikanti brenda objektit/godinës e/i cili/a do të furnizohet me energji, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të japë aprovimin që ambienti i përshtatur për kabinë, është brenda kushteve teknike dhe e aksesueshme nga ta.
- i) Pajisjet e lidhjes së re sigurohen, instalohen dhe testohen nga Aplikanti me shpenzimet e tij.
- j) Pas përfundimit të punimeve, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes merr masa për kryerjen e kolaudit dhe nëse punimet janë kryer në përputhje me kushtet teknike, atëherë brenda 3 ditë pune Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë pranimin. Nëse gjatë kontrollit konstatohen të meta teknike, atëherë Aplikanti është i detyruar të përfundojë apo korrigjojë të metat e konstatuara.
- k) Pas kolaudit të instalimeve dhe pas marrjes në dorëzim të kabinës elektrike, brenda 1 dite pune, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit raportin e vendosjes së sistemit të matjes (matësa, bokse kolektive, etj) së energjisë elektrike, i cili duhet të instalohet brenda 5 ditëve pune në TU dhe 10 ditëve pune në TM nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes.
- l) Verifikimi i matësit të energjisë elektrike realizohet nga subjekti i pavarur, i autorizuar për verifikimin e matësive të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Test raporti i verifikimit të matësit elektrik dorëzohet nga subjekti i pavarur tek klienti dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.
- m) Pas vendosjes së sistemit të matjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit urdhrin e vënies nën tension të pajisjeve. Prova dhe vënia nën tension e pajisjeve do të kryhet brenda 1 dite pune dhe do të kryhet nga strukturat përgjegjëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- n) Në rast se gjatë vënies nën tension të objektit, lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen, atëherë Aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht.
- o) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron aplikantin/klientin apo përdoruesin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij/tyre brenda 5 ditëve pune pas vënies nën tension. Operatori i Sistemit vë në dispozicion të aplikantit/klientit informacionin e nevojshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer.
- p) Afatet e realizimit të lidhjes së re do të jenë 60 ditë të ndara sipas hapave:
  - Jo më shumë se 25 ditë për procedurën e aplikimit tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, kontrollin e aplikimit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, identifikimin e pikës së lidhjes, përgatitjen e dizajnit dhe llogaritjen e shpenzimeve.
  - Jo më shumë se 30 ditë për marrjen e lejeve përkatëse dhe realizimin e të gjitha punimeve ndërtimore nga Aplikanti.
  - Jo më shumë se 5 ditë për instalimin e sistemit të matjes.



### 3.2 Burimet e reja të gjenerimit të energjisë elektrike

Aplikimi për lidhje të re për burime të reja të gjenerimit në rrjetin e **Tensionit të Mesëm**, do të bëhet pranë zyrave të Kujdesit të Klientit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në Tiranë.

- 1- Periudha e vlerësimit të kërkesës së bërë nga aplikanti dhe paraqitja për nënshkrim e “Marrëveshjes së Lidhjes së Re” nuk do të jetë më shumë se 20 ditë pune prej datës së paraqitjes.
- 2- Aplikanti duhet të paraqesë projektin elektrik të Burimit të gjenerimit dhe të linjës së transmetimit deri në pikën e lidhjes te OSSH. Ky projekt duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, të pasqyrojë të gjitha detajet teknike dhe parametrat kryesorë të pajisjeve së bashku me skemën principiale të tij.
- 3- Aplikanti do të kryejë projektin e lidhjes elektrike të burimit të gjenerimit me Sistemin e Shpërndarjes, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Lidhjes së re.
- 4- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë paraprakisht verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti dhe nëse aplikimi nuk është i plotë atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë aplikantin me shkrim brenda 5 ditëve pune prej datës kur aplikimi është dorëzuar për vlerësim.
- 5- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe në varësi të gjendjes së rrjetit elektrik në atë zonë, do të përgatisë mënyrën e lidhjes së objektit në rrjet.
- 6- Nëse aplikanti bie dakord me ofertën e paraqitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për t’u lidhur në sistemin e tij të shpërndarjes ai duhet të firmosë formularin e pranimit të ofertës brenda afatit prej 10 ditësh kalendarike. Në rast të kundërt propozimi bëhet i pavlefshëm dhe kërkesa për lidhje të re duhet të përsëritet.
- 7- Nëse aplikanti pranon ofertën, atëherë ai dorëzon formularin e pranimit të ofertës pranë OSSH.
- 8- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes pas pranimit të ofertës do të lidhë akt-marrëveshjen dypalëshe me subjektin aplikues. Më pas, Aplikanti harton projektin e pikës së lidhjes. Pas miratimit, OSSH do të njoftojë aplikantin për kryerjen e pagesës së plotë të tarifës për lidhjen e re. Nëse aplikanti nuk kryen pagesën e tarifës brenda 10 ditëve kalendarike prej momentit të miratimit të mënyrës së lidhjes së tij në rrjetin e shpërndarjes, atëherë aplikimi dhe marrëveshja e Lidhjes së re do të konsiderohen të pavlefshëm dhe i interesuari do të duhet të aplikojë përsëri për lidhje të re.
- 9- Pas pagesës së tarifës së lidhjes së re nga ana e aplikantit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të nxjerrë menjëherë lejen për fillimin e punimeve.
- 10- Të gjitha punimet për pikën e lidhjes (ambienti i dorëzimit dhe i matjes) do të realizohen nga OSSH.
- 11- Të gjitha punimet për ambientin e klientit në pikën e lidhjes dhe linjës së furnizimit me energji elektrike në burimin e energjisë do të realizohen nga aplikanti duke zgjedhur ai subjektin që do të kryejë instalimin e pajisjeve dhe komponentëve të lidhjes së re.

Instalimi i pajisjeve në Nënstacione që lidhen me traktet e hyrjes së linjave, projektimi dhe instalimi i tyre do të kryhet nga OSSH.

- 12- Pas përfundimit të punimeve dhe instalimeve, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

brenda 2 ditëve pune është i detyruar të inspektojë dhe të marrë në dorëzim punimet dhe instalimet e kryera nëpërmjet një procesverbali të veçantë. Nëse do të konstatohen të meta, atëherë ato do të riparohen nga ana e OSSH.

- 13- Aplikanti bashkëpunon me blerësin e energjisë elektrike për të realizuar vendosjen e sistemit të matjes së energjisë elektrike në pikën e lidhjes me sistemin e shpërndarjes, në përputhje me kërkesat e Kodit të Matjes.
- 14- Pas vendosjes së sistemit të matjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit urdhrin e vënies nën tension të pajisjeve. Prova dhe vënia nën tension e pajisjeve do të kryhet brenda 2 ditëve pune dhe do të kryhet nga strukturat përgjegjëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- 15- Në rast se gjatë vënies nën tension të objektit, lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen, atëherë OSSH është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht.
- 16- Nëse klienti shfrytëzon hapësirat e nënstacioneve për të instaluar pajisjet e tij si në godina dhe jashtë, duhet të paguajë një tarifë qiraje, e cila arrihet me një marrëveshje ndërmjet palëve, sipas dispozitave të Kodit Civil.

### **3.3 Procedura për zhvendosjen e aseteve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

- a) Për nevoja të ndryshme të subjekteve mund të kërkohet të zhvendosen ose të zëvendësohen asete të ndryshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Linjë ajrore, linjë kabllore, shtylla, kabina elektrike etj).
- b) Realizimi i zëvendësimit apo i zhvendosjeve të tilla, do të bëhet vetëm pas miratimit paraprak të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në përputhje me Procedurat dhe Afatet e përcaktuara në pikat 3.1.1, 3.1.2, 3.1.3 dhe 3.1.4 të kësaj Rregulloreje.
- c) Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të miratojë zhvendosjen, atëherë ajo do të kryhet sipas kushteve teknike të vetë kompanisë nga Aplikanti dhe të gjitha shpenzimet për realizimin e zhvendosjes së aseteve do të përballohen nga aplikanti sipas preventivit të miratuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.
- d) Pajisjet e lidhjes së re sigurohen, instalohen dhe testohen nga Aplikanti me shpenzimet e tij, sipas legjislacionit në fuqi.
- e) Tarifa e zhvendosjes së aseteve të OSSH hartohen nga OSSH sipas metodologjisë të miratuar nga ERE.

### **3.4 Mënyra e lidhjes në rrjet e burimeve të energjisë**

- a) Burimet e energjisë elektrike do të lidhen në rrjetin shpërndarës pasi Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të ketë kryer studimin e lidhjes dhe efektet që sjellin në atë pjesë të rrjetit prania e burimeve të reja të gjenerimit të energjisë elektrike.
- b) Burimet e reja do të preferohej që lidhja e tyre të realizohet në N/Stacionet e transformimit dhe nëse kjo mënyrë lidhjeje është e pamundur, atëherë të lidhen si pjesë shtesë e rrjetit ekzistues 6, 10, 20, 35 kV duke kryer shpenzime shtesë që lidhen me realizimin e lidhjes.
- c) Të gjitha shpenzimet shtesë që lidhen me realizimin e lidhjes, përforcimin e pjesës ekzistuese të rrjetit shpërndarës për efekt të realizimit të lidhjes, shtesat e mundshme në pjesën e tensionit të mesëm 6,10,20,35 kV dhe të tensionit të lartë në N/Stacione (kur kërkohet lidhja në to) do të përballohen nga aplikanti.

- d) Afatet e realizmit të lidhjes të burimeve gjeneruese në sistemin e shpërndarjes të OSSH, nuk duhet të kalojnë më shumë se dy vjet nga miratimi i pikës së lidhjes dhe nëse ky afat kalon, ai duhet të rifreskojë kërkesën për pikë lidhje duke mbartur të gjithë shpenzimet për çdo ndryshim të mundshëm në këtë sistem shpërndarës të OSSH.

### **3.5 Dokumentacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese**

1. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (Formulari i Aplikimit)
2. Fotokopje e vërtetimit të identitetit (Kartë identiteti)
3. Certifikatë regjistrimi në QKB (Për subjektet jofamiljare)
4. Gen-Plan i vendosjes së objektit.
5. Hartë që të tregojë vendndodhjen e objektit në terren në një shkallë të përshtatshme
6. Profilin gjatësor të linjës elektrike dhe të gjitha detajet e tjera teknike që lidhen me të.
7. Projektin e plotë të nyjes se si do lidhet objekti i ri në rrjetin e shpërndarjes.
8. Kopje të Licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektimin.
9. Kopje e kontratës (kartelës) së mëparshme që aplikanti mund të ketë pasur
10. Kontrata e koncesionit për ndërtimin e burimit gjenerues.
11. Llojin e burimit gjenerues dhe parametrat nominalë të tij përfshirë edhe X”(d)
12. Fuqia maksimale e gjeneruar aktive dhe reaktive
13. Skema principiale e brendshme e burimit gjenerues me të gjitha detajet teknike
14. Tipi i gjeneratorit sinkron dhe parametrat e tij
- 15.1. Parametrat kryesorë të transformatorit të fuqisë

### **3.5 Dokumentacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese**

#### **• Pika 3.5.1 "Burimet gjeneruese hidro**

1. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (Formulari i Aplikimit).
2. Fotokopje e vërtetimit të identitetit (Kartë identiteti).
3. Gen-Plan i vendosjes së objektit.
4. Hartë që të tregojë vendndodhjen e objektit në terren në një shkallë të përshtatshme.
5. Profilin gjatësor të linjës elektrike dhe të gjitha detajet e tjera teknike që lidhen me të.
6. Projektin e plotë të nyjes se si do lidhet objekti i ri në rrjetin e shpërndarjes.
7. Kopje të Licencës së inxhinierit elektrik që ka kryer projektimin.
8. Kontrata energjise elektrike për nevojat vetjake.
9. Kontrata e koncesionit (ose miratim nga Ministria) për ndërtimin e burimit gjenerues.
10. Fuqia maksimale e gjeneruar aktive dhe reaktive.
11. Skema principiale e brendshme e burimit gjenerues me të gjitha detajet teknike.
12. Tipi i gjeneratorit sinkron dhe parametrat e tij.
13. Parametrat kryesorë të transformatorit të fuqisë.

#### **Pika 3.5.2 "Burimet gjeneruese Fotovoltajke"**

1. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (Formulari i Aplikimit).
2. Fotokopje e vërtetimit të identitetit (Kartë identiteti).

3. Gen-Plan i vendosjes se objektit.
4. Harte qe te tregojë vendndodhjen e objektit ne terren ne nje shkalle te pershtatshme.
5. Profilin gjatesor te linjes elektrike dhe te gjitha detajet e tjera teknike qe lidhen me te.
6. Projektin e plote te nyjes se si do lidhet objekti i ri ne rrjetin e shpemdardjes.
7. Kopje te Licences se inxhinierit elektrik qe ka kryer projektimin.
8. Kontrata e energjise elektrike per nevojat vetjake.
9. Kontrata e koncesionit (ose miratim nga Ministria)per ndertimin e burimit gjenemes.
- 10.Fuqia maksimale e gjenemar.
- 11.Skema principiale e brendshme e burimit gjenemes me te gjitha detajet teknike.
- 12.Parametrat kryesore te transformatorit te fuqise.
13. Manuallet dhe skedat teknike te produkteve te sistemit PV, si9 jane: panelet, inverterat, kabllot etj.;

### Pika 3.5.3 "Burimet gjeneruese eolike"

- 1.Kerkese per lidhje ne rrjetin shpemdardes(Formulari i Aplikimit).
2. Fotokopje e vertetimit te identitetit(Karte identiteti).
3. Gen-Plan i vendosjes se objektit.
4. Harte qe te tregojë vendndodhjen e objektit ne terren ne nje shkaile te pershtatshme.
5. Profilin gjatesor te linjes elektrike dhe te gjitha detajet e tjera teknike qe lidhen me te.
6. Projektin e plote te nyjes se si do lidhet objekti i ri ne rrjetin e shpemdardjes.
7. Kopje te Licences se inxhinierit elektrik qe ka kryer projektimin.
8. Kontrata e energjise elektrike e nevojave vetjake.
9. Kontrata e koncesionit(ose miratim nga Ministria)per ndertimin e burimit gjenerues.
- 10.Fuqia maksimale e gjeneruar.
- 11.Skema principiale e brendshme e burimit gjenerues me te gjitha detajet teknike.
- 12.Parametrat kryesore te transformatorit te fuqise.

3.5.4 "Veteprodhuesit" me dokumentacionin perkates te listuar si me poshte me tre nenkategorit te ndara sipas fuqise, konkretisht:

#### • 0-10kWp

- 1.Kerkesa.
2. Deklaraten e konsumit mesatar te tij pergjate nje viti sipas historikut te dy viteve te fundit ose ne rast te mungeses te nje historiku, raportin e auditit energjetik te leshuar nga audituesi i certifikuar se bashku me certifikaten perkatese dhe propozimin per fuqine e instaluar.
3. Propozimin mbi modelin e matesit me dy drejtime skemae matjes neto dhe karakteristikat teknike te tij sipas standarteve te OSSH.
4. Relacioni teknik.
5. Kopje origjinale te aktkolaudimit te sistemit, firmosur nga projektues te licencuar per impiante te prodhimit te energjise elektrike te rinovueshme nga dielli (kat. 10c) dhe zbatues te licencuar per ndertimin e impianteve te prodhimit te energjise (kat. NP-IOA), se bashku me konfirmimin e veteprodhuesit te sistemitPV
6. Manuallet dhe skedat teknike te produkteve te sistemit PV, si9 jane; panelet, inverterat, kabllot, etj.

7. Licensa e inxhinierit projektues, i cili duhet te kete piken IOC ne license per projektim dhe NPIO per zbatim.

8. Karte identiteti

9. Numri kontrates ekzistuese te abonentit (pa debi) me fiiqi te njejte me fuqine e impiantit

veteprodhues.

10. Dokument pronesie te objektit ku do ndertohet impianti fotovoltaik.

• 11-50kWp

1. Kerkesa

2. Deklaraten e konsumit mesatar te tij pergjate nje viti sipas historikut te dy viteve te fundit

ose ne rast te mungeses te nje historiku, raportin e auditit energjetik te leshuar nga audituesi i fertifikuar se bashku me certifikaten perkatese dhe propozimin per fuqine e instaluar.

3. Projektin e miratuar nga persona fizike dhejuridike te licencuar per lidhjen e impiantitPV

me rrjetin e shpendarjes, ne perputhje me Kodin e Shpendarjes te miratuar nga ERE.

4. Propozimin mbi modelin e matesit me dy drejtime skema e matjes neto dhe karakteristikat

teknike te tij sipas standarteve te OSSH.

5. Relacioni teknik.

6. Kopje origjinale te aktkollaudimit te sistemit, firmosur nga projektues te licencuar per impiant te prodhimit te energjise elektrike te rinovueshme nga dielli (kat. 10c) dhe zbatues

te licencuar per ndertimin e impianteve te prodhimit te energjise (kat. NP-IOA), se bashku

me konfirmimin e veteprodhuesit te sistemitPV.

7. Manualet dhe skedat teknike te produkteve te sistemit PV, si9 jane: panelet, inverterat, kabllot, etj.

8. Te dhena mbi inverterin kryesor dhe karakteristikat e matesit te prodhimit te vendosur pas tij.

9. Licensa e inxhinierit projektues, i cili duhet te kete piken IDC ne license per projektim dhe NPIO per zbatim.

10. Karte identiteti.

11. Numri kontrates ekzistuese te abonentit (pa debi) me fuqi te njejte me fuqine e impiantit veteprodhues. Dokument pronesie te objektit ku do ndertohet impianti fotovoltaik.

• 51-500kWp

1. Kerkesa.

2. Deklaraten e konsumit mesatar te tij pergjate nje viti sipas historikut te dy viteve te fundit ose ne rast te mungeses te nje historiku, raportin e auditit energjetik te leshuar nga audituesi i 9ertifikuar se bashku me 9ertifikaten perkatese dhe propozimin per fuqine e instaluar.

3. Projektin e miratuar nga persona fizike dhejuridike te li9encuar per lidhjen e impiantit PV me rrjetin e shpendarjes, ne perputhje me Kodin e Shpendarjes te miratuar nga ERE.

4. Propozimin mbi modelin e matesit me dy drejtime skema e matjes neto dhe karakteristikat teknike te tij sipas standardeve te OSSH.
5. Relacioni teknik.
6. Kopje origjinale te aktkollaudit te sistemit, firmosur nga projektues te licencuar per impiante te prodhimite energjise elektrike te rinoveshme nga dielli (kat. 10c) dhe zbatues te licencuar per ndertimin e impianteve te prodhimite te energjise (kat. NP-IOA), se bashku me konfirmimin e veteprodhuesit te sistemit PV.
7. Manualet dhe skedat teknike te produkteve te sistemit PV, si9 jane: panelet, inverterat, kabllot, etj.
8. Te dhena mbi inverterin kryesor dhe karakteristikat e matesit te prodhimite te vendosur pas tij.
9. Licensa e inxhinierit projektues, i cili duhet te kete piken IOC ne license per projektim dhe NPIO per zbatim.
10. Leje nga bashkia per "Punime qe kryhen me deklarate paraprake punimesh" VKM 408, dt 13.05.2015 "Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit" e Ndryshuar.
11. Karte identiteti
12. Numri kontrates ekzistuese te abonentit (pa debi).
13. Dokument pronesie te objektit ku do ndertohet impianti fotovoltaik

### **Projektimi i kabinës së transformimit dhe mënyrës së lidhjes**

- a) Për Pikën e Lidhjes së miratuar, Aplikanti do të kryejë projektin ndërtimor dhe atë elektrik për kabinën e transformimit (në qoftë se është parashikuar në ofertën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) dhe mënyrën e lidhjes së saj me rrjetin e shpërndarjes. Projekti elektrik duhet të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- b) Punimet për realizimin e lidhjes së re në ambientet në pronësi të OSSH, do të kryhen nga vetë OSSH me pajisjet e përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes, me shpenzimet e aplikantit. Të gjitha punimet e tjera për realizimin e lidhjes së re duhet të bëhen nga vetë Aplikanti, sipas ligjeve në fuqi, duke respektuar në këtë mënyrë të gjitha standardet e cilësisë së materialeve dhe karakteristikat teknike sipas normave. Kjo mënyrë do të eliminojë të gjitha të metat e vërejtura gjatë kohës në rrjetin shpërndarës elektrik për menaxhimin aktual apo perspektiv të tij.
- c) Projekti do të përmbajë të gjitha kërkesat sipas specifikimeve të mëposhtme:
  - 1) Planimetria dhe vendndodhja e kabinës së transformimit si pjesë përbërëse e projektit ndërtimor në tërësi.
  - 2) Projektimi ndërtimor i detajuar i pikës së transformimit (përfshirë të gjitha prerjet tërthore të godinës së kabinës).
  - 3) Plani i vendosjes i të gjitha pajisjeve brenda pikës së transformimit.
  - 4) Planimetria e vendosjes së kablllove elektrike brenda dhe jashtë kabinës, si edhe prerja tërthore e kanaleve të kablllove.
  - 5) Skema elektrike principale e kabinës elektrike, duke pasqyruar të gjithë parametrat nominalë të pajisjeve elektrike, si edhe të gjitha detajet e tjera që lidhen me realizimin në tërësi të saj.
  - 6) Sistemi i tokëzimit të kabinës dhe të gjitha detajet që lidhen me realizimin e tij, brenda dhe jashtë kabinës elektrike
  - 7) Projektimi i linjave ajrore/linjave kabllore të fuqisë (TM -TU) dhe profili i linjës

në shkallën 1:1000.

- d) Projektimi dhe përzgjedhja e pajisjeve do të bëhet në përputhje me tipin dhe specifikimet teknike të bëra të njohura paraprakisht nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes pas pranimit të ofertës nga ana e aplikantit.
- e) Projektimi i kabinave do të bëhet sipas tipeve të mëposhtme:

**1. Kabina TIP 1: murature për furnizim të godinave të banimit dhe shërbimit (një ambient)**

Ky tip kabine do të projektohet që të ndërtohet në kufirin e pronësisë të aplikantit me dyer të aksesueshme nga jashtë godinës, në afërsi të rrugës. Kjo kabinë do të ketë një ambient në të cilën do të vendosen të gjitha pajisjet e kabinës.

**2. Kabina TIP 2: Kabina murature për furnizim me energji elektrike të objekteve industriale apo komerciale (me dy ambiente).**

Ky tip kabine do të vendoset në kufirin e pronësisë të aplikantit me dyer të aksesueshme nga jashtë dhe në afërsi të rrugës me dy ambiente në dispozicion të aseteve të OSSH. Në njërin ambient do të vendoset transformatori I fuqisë dhe në ambientin tjetër do të vendosen pajisjet komutuese së bashku me panelin e matjes. Në ambientin e matësit të energjisë do të vendosen dy dyer, ku njëra derë do të jetë e aksesueshme nga jashtë dhe e menaxhuar nga OSSH dhe dera tjetër do të jetë e aksesueshme nga brenda dhe e menaxhuar nga aplikanti.

**3. Kabina TIP 3: murature për furnizim me energji elektrike të objekteve industriale apo komerciale (me tre ambiente)**

Ky tip kabine do të vendoset në kufirin e pronësisë të aplikantit me dyer të aksesueshme nga jashtë dhe në afërsi të rrugës.

Kjo kabinë do të ketë dy ambiente në dispozicion të aseteve të OSSH dhe një ambient në dispozicion të aseteve të aplikantit. Në njërin ambient do të vendosen pajisjet komutuese, kurse në ambientin tjetër do të vendoset matësi i energjisë. Në ambientin e pajisjeve komutuese do të ketë një derë të aksesueshme nga jashtë e menaxhuar nga OSSH. Në ambientin e matësit të energjisë do të vendosen dy dyer, ku njëra derë do të jetë e aksesueshme nga jashtë dhe e menaxhuar nga OSSH dhe dera tjetër do të jetë e aksesueshme nga brenda dhe e menaxhuar nga aplikanti. Ambienti i tretë në të cilin vendosen pajisjet e transformimit dhe të komutimit të aplikantit do të jetë me derë nga brenda dhe e aksesueshme vetëm nga aplikanti.

**4. Kabina TIP 4: Shtyllore për furnizim të objekteve të ndryshme (grup banesash, komerciale, industriale etj.)**

Ky tip kabine do të përdoret për fuqi të transformatorit deri në 250 kva dhe do të vendoset jashtë konturit të sipërfaqes së rrethimit në një distancë jo më larg se 3 m nga kufiri i pronësisë dhe me linjë furnizimi në TM, e cila kalon në territore publike dhe është lehtësisht e kontrollueshme.

### **3.63.5 Vlefshmëria e dokumentacionit të paraqitur**

- a) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara dhe duhet të arkivohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

- b) Nëse nga vlerësimi paraprak i të dhënave të mësipërme, dokumentacioni i paraqitur konsiderohet i pamjaftueshëm, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka të drejtë të kërkojë aplikuesit të dhëna shtesë.

## **PJESA IV: TARIFAT PËR LIDHJET E REJA**

### **4.1 Parimet e tarifave**

- a) Tarifat për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike janë përcaktuar në përputhje me objektivat e mëposhtme:
- 1) mos-diskriminim
  - 2) transparencë që lidhet me përdorimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe pjesëve integrale të tij
  - 3) zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, në mënyrë që të sigurohet ruajtja e nivelit të cilësisë së furnizimit me energji elektrike
- b) Tarifat për Lidhjet e Reja janë të njëjta për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- c) Parimi kryesor për detyrimin për realizimin e Lidhjes së Re është: Ai person fizik apo juridik që kërkon ndryshime në rrjetin e shpërndarjes, do të mbulojë të gjitha shpenzimet që lidhen me ndryshimin e rrjetit të shpërndarjes për të realizuar lidhjen e re.

### **4.2 Punimet/shërbimet që do të paguhën nga aplikanti**

1. Aplikanti do të paguajë kostot që lidhen me shërbimet që do të kryhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe që përfshihen në tarifë, si më poshtë:
  - Pranimi dhe procesimi i aplikimit
  - Planifikimi i zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për të mundësuar lidhjen e objektit të ri (studimi i fizibilitetit);
  - Përcaktimi i pikës së lidhjes në Sistemin e Shpërndarjes;
  - Kontrollin dhe miratimin e projektimit të paraqitur nga Aplikanti;
  - Furnizimin dhe instalimin e pajisjeve të përfshira në lidhjen e re, e cila do të realizohet nga subjekti i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, kolaudimin e tyre si edhe testimin e të gjitha pajisjeve të përfshira në lidhjen e re.
  - Mbikëqyrja, monitorimi dhe kolaudimi i punimeve ndërtimore dhe instalimeve
  - Instalimi i aparateve matëse të energjisë elektrike
  - 50ml kabëll (koaksial ose fuqie sipas rasteve) për instalimin e matësit në klientët e pajisur me matës energjie me boks individual etj.
  - Lidhja me rrjetin e shpërndarjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
  - Vulosjen e bokseve individuale, vulosjen e transformatorëve matës të rrymës dhe tensionit.
2. Punimet/ Shërbimet që do të kryhen dhe përballohen nga Aplikanti janë:
  - Projektimi për realizimin e lidhjes së re



- Kryerja e të gjithë punimeve me karakter ndërtimor dhe elektrik (kabina, kanalet e kablllove, pajisjet komutuese, pajisjet transformuese etj)
- ~~— Koston e pjesës së kabëllit më shumë se 50ml, vlera e të cilit do të përcaktohet referuar çmimit mesatar të këtij kabëlli në librat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. (klientët e pajisur me matës energjie me boks individual)~~
- Hapja e kanaleve të kablllove për realizimin e nyjeve bashkuese me rrjetin ekzistues shpërndarës, materialet elektrike që realizojnë lidhjen me rrjetin ekzistues (terminale, mufte, etj.), si dhe rehabilitimin (e përkohshëm dhe të përhershëm) të terrenit, duke përfshirë edhe sistemet rrugore..... **Pjesa e kabëllit me shume se 50 ml, hapja e kanaleve te kablllove per realizimin e nyjeve bashkuese me rrjetin ekzistues shpemdare, materialet elektrike qe realizojne lidhjen merrjetin ekzistues (terminale, mufte, etj), si dhe rehabilitimin (e perkohshem dhe te perhershem) teterrenit, duke perfshire dhe sistemet rrugore.**
- Testimi i lidhjes së realizuar,
- Lejet e duhura për ciklin e punës

#### 4.3 Mënyra e pagesës

- a) Aplikanti duhet të kryejë një pagesë për tarifën e lidhjes së re, e cila mbulon shpenzimet e përcaktuara si më sipër.
- b) Aplikanti do të mbulojë vetë shpenzimet e të gjitha punimeve dhe pajisjeve shtesë që janë të nevojshme për të realizuar lidhjen e re.
- c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të zbatojë praktikën e pagesës së plotë në avancë për të gjitha lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese.
- d) Në fund të kryerjes së punimeve, në rast se OSSH do të jetë operatori i licencuar, i përzgjedhur nga Aplikanti, për realizimin e lidhjes së re ose modifikimin e asaj ekzistuese, ajo do të përgatisë një faturë të detajuar të kostove, sasive dhe çmimeve të punimeve dhe materialeve të përdorura faktikisht për realizimin e lidhjes së re ose modifikimin e një lidhjeje ekzistuese, tek e cila në asnjë rast çmimet e përdorura nuk mundet të jenë më të lartë se vlera në treg e të njëjtit mall në momentin e realizimit të punimeve të lidhjes. Në rast diferencash mes preventivit të punimeve dhe kostove reale, palët sipas rastit do të paguajnë diferencat ose rimburojnë ato palës tjetër.
- e) Tarifa e T3 për fuqinë e kërkuar e cila paguhet nga aplikanti, nuk mund të jetë më e lartë se 300% e të ardhurave për frymë. Mbulimi i pjesës tjetër të tarifës që kalon shumën e përcaktuar më sipër, do të jetë objekt i rregullimit nga ERE.

#### 4.4 Struktura e tarifave të lidhjes së re

- a) Tarifat për një lidhje të re ose modifikim lidhjeje ekzistuese (Tarifat e Lidhjes) do të llogariten duke marrë parasysh parimet e përcaktuara në këtë rregullore.
- b) Tarifat e Lidhjes do të varen nga kërkesat e aplikantit, disponibiliteti i rrjetit të shpërndarjes tek pika e lidhjes, fuqia rezervë (nëse ka) tek pika e lidhjes dhe karakteristika të tjera që lidhen me realizimin e saj, duke përfshirë fuqinë e kërkuar dhe nivelin e tensionit
- c) Tarifat e Lidhjes përbëhen nga tarifat e mëposhtme: **T1, T2, T3, dhe T4**

**T1** – Tarifa e studimit dhe vlerësimit e miratimit të projektimit

**T2** – Tarifa e distancës

**T3** – Tarifa e fuqisë (lekë / kw fuqi të kërkuar)

**T4** – Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

**TABELA E TARIFËS T2 SIPAS DISTANCËS për lidhje në TU**

Tarifa e distancës në TU		Vlera e fiksuar e tarifës	Vlera e shtuar për çdo 100 m
a.	Brenda 200 m	2000	-
b.	Për çdo 100 m të shtuar		1000

**TABELA E TARIFËS T2 SIPAS DISTANCËS për lidhje në TM**

Tarifa e distancës në TM		Vlera e fiksuar e tarifës	Vlera e shtuar për çdo 1 km
a.	Brenda 1 km	4500	-
b.	Per çdo 1km të shtuar		4500

Tarifa T4 - tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes do të përbëhet nga këta komponentë :

1. Tarifë për azhurnimin e rrjetit;
2. Tarifë për shpenzime administrative;
3. Tarifa e verifikimit/kolaudimit fillestar të matësit monofaze dhe trefazor, referuar parashikimeve të nenit 77 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

#### **4.5 Kushtet e tjera për lidhje në rrjetin shpërndarës**

##### **a) Rrjeti i tensionit të ulët 0,4 kV**

Fuqia minimale e instaluar për të realizuar lidhjen e energjisë elektrike në tension të ulët 0,4 kV do të jetë deri 5 kW për rrjetin 1 fazor dhe mbi 5 kW për rrjetin 3 fazor

**b) Rrjeti i tensionit 6, 10 kV**

Rrjeti me tension 6 dhe 10 kV është në proces kalimi dhe transferimi në rrjetin me shkallë tensioni 20 kV. Në këtë fazë kalimtare, mënyra e realizimit të lidhjeve të reja në rrjetin e tensionit të mesëm 6, 10 kV, kur parashikohet ndërtimi i kabinës elektrike, do të realizohet me thikë-sigurese të TM. Aplikanti do të jetë vetë përgjegjës për ndryshimin e paisjeve dhe kryerjen e punimeve nëse në të ardhmen ky rrjet shpërndarës pranë objektit që është lidhur do të zëvendësohet me rrjetin 20 kV.

**c) Rrjeti i tensionit 20 kV**

Lidhja e kabinave elektrike në rrjetin shpërndarës me tension 20 kV do realizohet nëpërmjet çelave (paneleve) të TM sipas strukturës: Çelë Hyrje - Çelë Dalje dhe Çelë Transformatori.

**d) Kabinat shtyllore 6, 10, 20 kV**

Kabinat shtyllore do të përdoren kryesisht në zonat rurale por ato mund të ndërtohen edhe në zona urbane, në varësi të analizës dhe vendimit të vetë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Mënyra e realizimit të tyre do të jetë sipas skemës Thikë -Siguresë- Shkarkues dhe fuqia e transformatorit të fuqisë do të jetë 50-250 kVA.

**e) Rrjeti i tensionit 35 kV**

Pranimi dhe mënyra e realizimit të lidhjeve të reja në rrjetin e tensionit 35 kV do të bëhen në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe rregullat e brendshme të Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Mënyra e realizimit të tyre do të jetë sipas skemës Thikë-Siguresë-Shkarkues dhe fuqia minimale e transformatorit të fuqisë për të pranuar vlerësimin e aplikimeve në këtë rrjet tensioni do të jetë 800 kVA.

**f) Fuqizimi i kabinave të transformimit 6, 10, 20 kV në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kryen analizën dhe vlerësimin e njësive të transformimit që ndodhen pranë vend ndodhjes së objektit të ri që kërkon lidhje të re apo shtesë fuqie. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të vlerësojë çdo rast dhe në varësi të gjendjes së rrjetit, gjendjes së kabinës ekzistuese, mundësive reale për transformatorë fuqie rezervë; perspektivës së zhvillimit në atë zonë; ai (OSSH) mund të vendosë të bëjë vetë fuqizimin e kabinës ekzistuese dhe aplikanti të lidhet në tensionin e ulët duke paguar tarifën respektive.

**4.6 Tarifat për lidhje në tension të ulët**

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të ulët 0.4 kV

a) Konsumatorë Familjarë

T1 = 1000 Lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 2,000 Lek/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

- b) Konsumatorët Jofamiljarë

T1 = 5000 Lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 2.500 Lek/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

#### **4.7 Tarifat për lidhje në tension të mesëm**

- a) Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të mesëm 6, 10 dhe 20 kV (aplikanti do të ndërtojë kabinë elektrike)

T1 = 23000 Lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 1.700 Lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

- b) Për konsumatorët në godina banimi dhe shërbimi, në tarifën T4 nuk do të përfshihet tarifa për azhurnimin e rrjetit .

#### **4.8 Tarifat për lidhje në tension të mesëm 35 kV**

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të mesëm 35 kV

T1 = 23000 Lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 2,000 Lekë/kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

#### **4.9 Tarifat për shtesë fuqie, modifikim lidhje ose transferim**

- a) Konsumatorë Familjarë

T1= 0 Lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 2,000 Lekë/kW (kundrejt fuqisë shtesë të kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

- b) Konsumatorët Jofamiljarë në tension të ulët

T1 = 0 lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 2.500 Lekë/kW (kundrejt fuqisë shtesë se kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

- c) Konsumatorët Jofamiljarë në tension të mesëm

T1 = 0 lekë

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 1700 Lek/kW (kundrejt fuqisë shtesë të kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

d) Konsumatorët Jofamiljarë në tension 35 kV

T1 = 0 lek

T2 = sipas tabelës së distancave

T3 = 1700 Lek/kW (kundrejt fuqisë shtesë të kërkuar)

T4 = Tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe matjes

#### 4.10 Tarifat për lidhje në N/Stacione

Lidhja e re në zbarat e rrjetit shpërndarës të N/Stacioneve mund të kryhet duke vlerësuar paraprakisht gjendjen ekzistuese të N/stacionit dhe mundësinë e lidhjes në të.

- a) Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes disponon çelë në impiantin shpërndarës atëherë aplikanti do të detyrohet të përballojë jo vetëm shpenzimet për ndryshimin e pajisjeve (Transformator rryme, kokë kablli etc), por edhe këto tarifa shtesë:

Tarifa e përdorimit të çelës ekzistuese: 150,000 Lekë

Tarifa modifikim lidhjeje: 50,000 Lekë

- b) Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk disponon çelë në impiantin shpërndarës atëherë aplikanti do të sigurojë dhe instalojë vetë çelën në objekt dhe detyrohet të paguajë:

Tarifa modifikim lidhjeje: 50,000 Lekë

- c) Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të instalojë vetë një çelë në objekt për të realizuar lidhjen e kërkuar atëherë aplikanti do të detyrohet të paguajë:

Tarifa e përdorimit të çelës së re: 1,000,000 Lekë

Tarifë modifikim lidhjeje: 50,000 Lekë

- d) Për të gjitha rastet e mësipërme matja dhe faturimi i energjisë elektrike do të bëhet nëpërmjet një paneli matjeje të vendosur në N/Stacion sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Matjes. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për sigurimin dhe instalimin e sistemit matës respektiv.

#### 4.11 Tarifa për rastet e lidhjes nga disa burime të energjisë elektrike

Në përputhje me pikën 1.14, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të aplikojë një tarifë shtesë për rastet kur kërkohet dhe miratohet realizimi i lidhjes së re nga dy burime energjie të pavarura.

Për këto raste, Përdoruesi ose Aplikanti do të paguajë tarifën përkatëse për secilën lidhje sipas kësaj Rregulloreje. Procedura dhe kushtet do të jenë të njëjta sikurse në rastin kur lidhja do të realizohej nga një burim i vetëm furnizimi.

#### 4.12 Tarifa për lidhjen e burimeve të gjenerimit të energjisë elektrike

Për rastin kur në Sistemin e Shpërndarjes do të lidhen burime të gjenerimit të energjisë elektrike, tarifa e lidhjes do të përbëhet vetëm nga këto komponentë:

T1 = 10 000 Lekë

T2 = 100 000 Lekë

$$T3 = 0$$

$T4 =$  Tarifa për kolaudim fillestar të matësit të energjisë elektrike

Në rast se lidhja e burimeve të energjisë do të bëhet në zbarat e rrjetit shpërndarës të N/Stacioneve në pronësi të Operatori i Sistemit të Shpërndarjes atëherë do të aplikohen edhe tarifat shtesë sikurse janë përcaktuar në pikën 4.11.

#### **4.13 Kontrolli i kërkesës maksimale për fuqi**

- i. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kontrollojë kërkesën maksimale për furnizimin me energji elektrike nga çdo Klient i lidhur në tension të ulët duke përdorur Automat ngarkese.
- ii. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kontrollojë kërkesën maksimale nga çdo Klient të lidhur në tension të mesëm duke përzgjedhur koeficientin e përshtatshëm të transformimit të Transformatorit të Rrymës.
- iii. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kontrollojë nivelet e tensionit maksimal dhe minimal si dhe stakimin e gjeneruesit nga mbrojtja e tensionit maksimal.

#### **4.14 Sistemi i matjes së energjisë elektrike**

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për të siguruar dhe instaluar sistemin e matjes në TU ,TM (boks individual me matës 1-fazor dhe 3 -fazor, panel matje TU ,T.M. të kompletuar me matës dhe transformatorë rryme, boks kolektiv të kompletuar me matës, dhe transformatorët e rrymës).
2. Për klientët individualë me fuqi të instaluar  $\geq 200$  kVA sistemi i matjes do të realizohet nëpërmjet instalimit të çelës së matjes në TM për nivele të tensionit 6 dhe 10 kV.
3. Për klientët individualë me fuqi të instaluar  $\geq 400$  kVA sistemi i matjes do të realizohet nëpërmjet instalimit të çelës së matjes në TM për të nivele të tensionit 20 dhe 35 kV.
4. Në rastin e burimeve të reja të energjisë, kërkesat për të gjithë elementet e sistemit të matjes duhet të plotësojnë kriteret teknike të blerësit (OSSH). Aplikanti është i detyruar të bashkëpunojë me blerësin në procesin e zgjedhjes dhe instalimit të sistemit të matjes në përputhje me specifikat teknike të blerësit. Sistemi i matjes i instaluar pa miratimin e blerësit OSSH nuk do të konsiderohet i rregullt dhe nuk do të vulozet prej tij. Paraqitja skematike për të gjitha rastet do të realizohet sipas katalogut të matjes (Aneksi 2).

#### **4.15 Mirëmbajtja**

Lidhjet operohen prej operatorëve të rrjetit, të cilët kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen e tyre. Kostoja, për kontrollin dhe mirëmbajtjet parashikuar në Rregulloren e Shfrytëzimit dhe Sigurimit Teknik, paguhet prej përdoruesit, sipas marrëveshjes së dakordësuar mes palëve.

### **PJESA V: PRONËSI A MBI LIDHJEN E RE**

## **5.1 Kufijtë e pronësisë**

1. Linjat e lidhjes të Tensionit të Ulët, si asete të lidhjes do të jenë gjithmonë pronë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
2. Për sa i përket Përdoruesve ose Aplikanteve që kërkojnë pikë lidhjeje në Tension të Mesëm, kufijtë e pronësisë do të përcaktohen në çdo rast nga marrëveshje të veçanta ndërmjet palëve.
3. Pronësia e aseteve të lidhjes se re, që i shtohen rrjetit ekzistues është e përdoruesit, deri në amortizim të plotë të aseteve apo në përfundim të autorizimit të dhënë, bazuar në marrëveshjen e lidhjes, nënshkruar ndërmjet palëve. Pas amortizimit të plotë të aseteve të lidhjes, pronësia e tyre kalon tek operatori i rrjetit. Lidhjet operohen prej operatorëve të rrjetit, të cilët kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen e tyre. Kostoja për mirëmbajtjet paguhet prej përdoruesit, sipas parashikimeve të bëra në pikën 4.15 të kësaj Rregullore.

## **5.2 Të drejtat e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme**

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të blejë ose të ketë të drejtën e uzufuktit pa shpërblim mbi pasurinë e paluajtshme me destinacion kabine elektrike, sipas parashikimeve të bëra në legjislacionin në fuqi.
2. Uzufukti do të krijohet me marrëveshje noteriale midis palëve, do të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe do të realizohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.
3. Ndryshimi i pronarit të pasurisë së paluajtshme nuk do të çënojë të drejtën e uzufuktit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

## **PJESA VI: DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

- 6.1 Asetet e paluajtshme të përfituara “pa shpërblim” nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas kësaj Rregullore nuk do të përfshihen në Bazën e Rregulluar të Aseteve, për efekt të llogaritjes së tarifave .
- 6.2 Kjo rregullore është objekt rishikimi, me vendim të Bordit të ERE-s, sipas Rregullores së Organizimit Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s.
- 6.3 Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

### ANEKS 3

## TARIFAT PËR LIDHJET E REJA ME SISTEMIN E SHPËRNDARJES E VETËPRODHUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA DIELLI ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR DERI NË 500 KWP

### **T1 – TARIFA E STUDIMIT DHE VLERËSIMIT E MIRATIMIT TË PROJEKTIMIT**

T1 është tarifë fikse, lidhur me kostot për studimin e projektit të lidhjes së re dhe studimit dhe azhurnimit të pikës së lidhjes me metodologjinë GIS. Sipas kategorizimit të klientëve dhe nivelit të tensionit ku kërkohet lidhja e re, është përcaktuar:

- 1) Për klientët familjarë – T1= 1000 lekë
- 2) Për klientët jofamiljarë në tension të ulët – T1= 5000 lekë
- 3) Për klientët e lidhur në tension të mesëm 6/10/20/35 kV – T1= 23000 lekë
- 4) Për shtesë fuqie, modifikim lidhje, transferim lidhje – T1= 0 lekë

**T2 – TARIFA E DISTANCËS = 0 lekë**

**T3 – TARIFA E FUQISË = 0 lekë**

**T4 – TARIFA E SHËRBIMEVE PËR REALIZIMIN E LIDHJES SË RE DHE KOLAUDIMIT FILLESTAR TË MATËSIT**

Tarifa T4 është tarifë fikse e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re dhe verifikimit/kolaudimit fillestar të matësit. Kjo tarifë përbëhet nga këta komponentë :

- 1) Tarifë për azhurnimin e rrjetit ..... 1500 lekë
- 2) Shpenzime administrative ..... 1000 lekë
- 3) Tarifa për verifikimin/kolaudimin fillestar të matësive
  - monofazë .....
  - trefazor .....

Tarifa për verifikimin/kolaudimin fillestar të matësit, i referohet parashikimeve të nenit 77 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.



## **Aplikim per lidhje te re/shtese fuqie/transferim kontrate 0-20kW**

### *Te dhenat personale/ shoqerise*

Emri .....

Atesia .....

Mbiemri .....

Nr. i Dokumentit te Identifikimit ID.....

NUIS.....

Adresa e objektit.....

Nr. telefoni .....

E-mail: .....

Ne rast te shtese fuqie/transferim kontrate (Kodi i Kontrates) .....

Kategoria/Subjekti (familjare/privat/ambjent i perbashket) .....

Fuqie e kerkuar.....

Fuqia e Instaluar.....

**Referuar Rregullores per Lidhjet e reja ne sistemin e shperndarjes miratuar me Vendimin Nr.166, date 10.10.2016,te Bordit te ERE,e ndryshuar pika 1.11 "Pergjegjesia e instalimeve te brendshme elektrike te objektit te aplikuesit",:**

Une..... deklaroj, qe te gjitha instalimet e brendshme dhe tokezimin e objektit i kam bere me inxhinier elektrik/Studio te licensuar konform kushteve teknike dhe rregullores se shfrytezimit teknik;

Se jane zbatuar te gjitha normat e sigurimit teknik ne perputhje me standardin ISO 18001, instalimet jane kryer ne perputhje me kerkesat dhe kushtet teknike te OSSH sh.a.dhe jane testuar ne perputhje me te gjitha protokollet dhe detyrimet ligjore ne fuqi dhe do te jene konform standardeve teknike, per te mos shkaktuar ndikim negativ ne rrjetin e shperndarjes.

Konfirmoj se i kam kryerte gjitha punimet ndertimore ne objektin qe kerkon te lidhet me energji elektrike.

Konfirmoj qe kam keto kontrata (pika lidhje) furnizimi me energji elektrike si me poshte:

.....

Une i/e nenshkruari/a .....ne dijeni te pergjegjesive ligjore qe rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e te dhenave e rrethanave te rreme, nen pergjegjesine time personale deklaroj se te dhenat e paraqitura ne kete formular jane te verteta dhe ne respektim te ligjit Nr.9887 "Per mbrojtjen e te dhenave personale", autorizoj me vullnetin tim te lire institucionin, te perpunoje dhe te perdore te dhenat e mia personale, per qellime statistikore dhe te shqyrtimit te aplikimit. Gjithashtu njoh dhe pranojte gjitha kushtet dhe detyrimet ne lidhje me ofrimin e sherbimit te furnizimit me energji elektrike qe burojne nga legjislacioni ne fuqi.